

VENDIM
Nr. 688, datë 6.12.2023

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 212, DATË 11.3.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR
FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nëndarjet “i” dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2.3, të vendimit nr. 212, datë 11.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 2.4, me këtë përmbajtje:

“2.4 Përveç përcaktimeve të pikës 2.3, të këtij vendimi, fondi që do të përdoret, i miratuar në buxhetin e vitit 2023, të jetë në masën 124 350 534 (njëqind e njëzet e katër milionë e treqind e pesëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë e katër) lekë pa TVSH, nga të cilat:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 10 174 823 (dhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëqind e njëzet e tre) lekësh pa TVSH;

b) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi prej 114 175 711 (njëqind e katërbëdhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e njëmbëdhjetë) lekësh pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku